

**REZYME MBI TEZËN E NIVELIT MASTER NË SHOQËRI CIVILE DHE
ZHVILLIM LOKAL**

**KOSOVA PËRBALLË SFIDAVE TË MIJËVJEÇARIT: POLITIKAT E
ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE AGJENDA 2030**

NGA

AJFER TUNA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

Departamenti i Shkencës Politike

Prishtinë

Shkurt 2022

KOSOVA PËRBALLË SFIDAVE TË MIJËVJEÇARIT: POLITIKAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE AGJENDA 2030

Mentor: Prof.Dr. Anton Vukpalaj

Kosova si shteti më i ri në Evropë, përballet me shumë sfida përveç atyre politike dhe ekonomike. Një ndër synimet kryesore të Kosovës është anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Bashkimin Evropian (BE) dhe në NATO. Përveç problemit të mosnjohjes së shtetësisë së Kosovës nga pesë vende të BE-së, një problem madhor është edhe mosnjohja e Kosovës nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Pavarësisht kësaj sfide që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare, politikat gjeostrategjike të “elefantëve të mëdhenj” dhe me vetë diplomacinë kosovare, Kosova ka marrë përsipër harmonizimin e legjislacionit vendor – në të gjitha fushat e mundshme – jo vetëm me Acquis Communautaire të BE-së, por edhe me dokumentet strategjike globale të hartuara dhe miratuara njëzëri nga gjithë Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Dokumentet kryesore strategjike të hartuara nga OKB-ja dhe të përvetësuara nga shtetet anëtare, janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), ose Agjenda 2030.

Agjenda 2030 duhet parë si një skicë e përbashkët globale, përmes së cilës Kombet e Bashkuara, por edhe shtetet, individët, korporatat, organizatat, agjencitë, shoqëria civile, individët, bashkojnë përpjekjet për të pëmirësuar jo vetëm të ardhmen e planetit dhe njerëzimit, por edhe të tashmen. Shtetet që janë zotuar për zbatimin e Agjendës 2030, do të duhet të punojnë jashtëzakonisht për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe hartimin e strategjive adekuate për të mundësuar zbatimin e prioriteteve të caktuara nga OKB-ja dhe ekspertët globalë.

Kosova vazhdon të ballafaqohet me probleme të ndryshme si, korrupsioni, mungesa/kufizimet e ujit të pijshëm, dobësimi i kapaciteteve energjetike përfshirë rritjen e pakontrolluar të çmimeve në këtë sektor, përfaqësimi i dobët i grave në vendimmarrje dhe pozita ekonomike e pamjaftueshme e tyre, probleme në sundimin e ligjit, cilësia e ulët e sistemit arsimor, ndotje e pakontrolluar mjedisore, papunësi e lartë sidomos tek të rinjtë, “brain-drain” apo largimi i kapacitetit intelektual prej Kosovës, emigracioni në rritje, etj. Agjenda 2030 i trajton të gjitha këto fenomene, dhe më shumë se kaq.

Qëllimi i hulumtimit tim është identifikimi i objektivave të Agjendës 2030, përfshirja e tyre në dokumentet strategjike të institucioneve të Kosovës, dhe zbatimi apo moszbatimi i tyre në nivel qendror dhe lokal. Për qëllim të këtij studimi, kam hulumtuar dokumentet strategjike të hartuara nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe institucione të tjera vendore, duke sjellë krahasime me vendet fqinjë – të cilët kanë specifika më të përafërt me Kosovën – por edhe dokumentet strategjike të hartuara nga OKB-ja, Banka Botërore, USAID-i, BE-ja, etj.

Ky hulumtim pasqyron gjendjen aktuale të OZHQ-ve në Kosovë, si dhe mungesën e infrastrukturës ligjore, teknike, zhvillimore për zbatimin e plotë dhe në kohë. Po ashtu, ky hulumtim paraqet pamundësinë e institucioneve të Kosovës për të ofruar një pasqyrë të qartë të situatës faktikë në terren, për mungesë koordinimi ndër-institucional, mungesë informacioni dhe të dhënash, si dhe mungesë ekspertize.

Punimi përbëhet nga shtatë (7) kapituj: **kapitulli i parë** shtjellon qëllimin e temës, politikat e ndjekura si dhe metodologjinë e hulumtimit; **kapitulli i dytë** shpalos një ekspozë të Agjendës 2030, historikut dhe objektivave të vendosur; **kapitulli i tretë** shtjellon politikat e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus në ekonomi, mjedis dhe shoqëri; **kapitulli i katërt** hedh dritë mbi rolin e Kombeve të Bashkuara në OZHQ-të në Kosovë; **kapitulli i pestë** fokusohet tek zbatimi i OZHQ-ve në Kosovë, përfshirë hartimin e strategjive kombëtare për harmonizimin e legjislacionit vendor me OZHQ-të; **kapitulli i gjashtë** hedh dritë mbi sfidat me të cilat përballet Kosova gjatë zbatimit të OZHQ-ve, sidomos duke marrë parasysh specifikat vendore, sërisht me fokus në ekonomi, mjedis dhe shoqëri; dhe **kapitulli i shtatë** bën përmylljen e temës përmes konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Si përfundim, procesi i OZHQ-ve në Kosovë do të ishte shumë i dukshëm në rast se do të kishte pasur zbatim metodik të tyre si dhe zhvillim strategjish e politikash të cilat mundësojnë zbatimin e OZHQ-ve. Mungon qasja pragmatike për të qenë efikasë në arritjen e Agjendës 2030, koordinimi i duhur me organizatat ndërkombëtare që ofrojnë ekspertizë në këtë fushë, baza ligjore që mundëson harmonizimin e strategjisë Agjenda 2030 me legjislacionin vendor, nuk ka koordinim mes niveleve qendrore dhe lokale të vendimmarrjes, mungojnë në masë të dhënat që duhen mbledhur për të përcaktuar shkallën e progresit apo regresit për zbatimin e Agjendës 2030, mungon interesi për Agjendën 2030 nga ana e institucioneve të Kosovës, si dhe prioritizimi i objektivave të OKB-së sipas specifikave vendore. Megjithatë, nëse Kosova dëshiron të ketë progres në fusha si, përafrimi me BE-në dhe antarësimi në BE-, NATO dhe OKB, atëherë Agjenda 2030 do të duhet të shndërrohet në një dokument të ‘gjallë’ i cili do të

definojë progresin e Kosovës në secilin sektor ku ka ngecje dhe ku nevojitet ndryshim rrënjësor për përmirësimin e jetëve të qytetarëve.